
10 KONTROLLI I NJËSUAR I EMËRTIMEVE LËNDORE

Në këtë kapitull përshkruhen karakteristikat e kontrollit të njësuar të emërtimeve lëndore. Janë prezantuar vetëm komponentët e modulit COBISS3/Katalogimi dhe procedurat me regjistrimet e njësuara, të cilat në klasën **Regjistrimi i njësuar (SGC)** janë ndryshe nga ato në klasën **Regjistrimi i njësuar (CONOR)**.

Me fillimin e aplikimit të kontrollit të njësuar për emërtimet lëndore ndryshon mënyra e vendosjes së të dhënave në fushat me kontroll të njësuar 60X (shih kap. 7.3.4.2).

Nëse keni autorizimin CAT_SUBLINK në fushat 60X mund të vendosni emërtimet lëndore përmes bazës së njësuar të të dhënave SGC.

Për lidhjen e emërtimeve lëndore në regjistrimet bibliografike dhe regjistrimeve të njësuara SGC shërben nënfusha 3 – *Numri i regjistrimit të njësuar*, ku shënohet numri identifikues i regjistrimit të njësuar SGC. Në bazë të kësaj nënfushe në regjistrimin bibliografik në mënyrë automatike vendoset pikëqasja e njësuar. Në të njëjtën kohë shtohet edhe nënfusha 2 me kodin e sistemit "SGC" – *Lista e përgjithshme e emërtimeve lëndore COBISS.SI*. Nënfusha 3 mundëson edhe bashkërendimin e mëvonshëm automatik të regjistrimeve bibliografike me ato të njësuara (shih kap. 10.5).

Variantet e pikëqasjes dhe pikëqasjet në lidhshmëri nuk shtohen në regjistrimin bibliografik.

Nëse nuk keni autorizimin CAT_SUBLINK, emërtimet lëndore vendosni në mënyrë manuale, ashtu siç keni vepruar deri tani.

Programi mundëson edhe redaktimin SGC që e kryen këshilli redaktues i listës së emërtimeve lëndore.

Lista e përgjithshme e emërtimeve lëndore COBISS është në gjuhën shqipe, për këtë arsye është e disponueshme vetëm në sistemin COBISS.SI.

Nënkapitujt:

- Ndërfaqja për katalogim
- Dritarja për kërkim

- Paraqitësi
- Kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve